



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 116, Datë 01.04.2021

PËR

REFUZIMIN E KËRKESËS PËR LEHTËSIM TË NGARKESËS SË GJYQTARES SË KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR, ZNJ.{...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 174/a, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61 dhe 89, shkronja b) të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 23 dhe 25 pika 3, shkronja dh) të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenin 26 pika 1 shkronja c) të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 149, pika 2 të Kodit Zgjedhor, pas shqyrtimit të kërkesës së gjyqtares {...} , protokolluar me aktin nr. 1096 prot, datë 11.03.2021, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës së gjyqtares së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, znj. {...} , për marrjen e masave të tjera për lehtësimin e ngarkesës së saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, përtej ngarkesës së reduktuar të pjesëmarrjes së saj në procedurat e ndarjes së çështjeve me short në masën 50 %.
2. Njoftimin e këtij vendimi znj. {...} , gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, njëkohësisht kryetare në detyrë e kësaj gjykate.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR